

Nr. 01/312 Prot.

Gjiilan, më 18/03/2019

PROTOKOLL BASHKËPUNIMI

midis:

Universitetit "Kadri Zeka" Gjiilan dhe S.T.A (Country Master Distributor for ETS)

Parime të përgjithshme

Ky Protokoll Bashkëpunimi lidhet më 18/03/2019, mes Universitetit "Kadri Zeka" Gjiilan, tani e tutje si UKZ, përfaqësuar nga **Rektori, Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi** dhe S.T.A (*Country Master Distributor for ETS*), tani e tutje si S.T.A, përfaqësuar nga **Përfaqësuesja e Përhershme, Prof. Ass. Ines Dika**.

Kjo marrëveshje bashkëpunimi nënshkruhet, duke u bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ 03/2018 për Gjuhët për ciklin e studimit të dytë apo të tretë, vendimi numër 16/33 i datës 22/02/2018.

Neni 1

Objekti dhe qëllimi i Protokollit të bashkëpunimit

Objekti i këtij Protokoll është të garantojë bashkëpunimin midis UKZ dhe S.T.A, me qëllim sigurimin e standardit gjatë procesit të testimit të gjuhës Angleze e Frengje dhe të garantojë certifikimin zyrtar të rezultatit të arritur gjatë testimit në ambientet e UKZ-së.

Neni 2

Kohëzgjatja e Protokollit

Ky Protokoll lidhet për një periudhë kohore prej 3 (tre) vjetësh, me të drejtë përsëritje me marrëveshje të palëve. Zbatimi i këtij Protokoll fillon më 18/03/2019 dhe është e vlefshme deri më 17/03/2022.

Neni 3

Të drejtat dhe detyrimet e S. T. A

1. Merr përsipër të testojë studentët e UKZ-së dhe jo vetëm, në formatin “**paper based**” që janë për Gjuhën Angleze, përkatësisht 2 (dy) variantet e testeve, **TOEFL ITP®** dhe **TOEIC® L&R** dhe për Gjuhën Frengje, përkatësisht testi **TFI™**. Të tre testet janë të akredituara nga CEFRL si teste të standardizuara për njohjen e gjuhës angleze dhe frengje, si edhe **Udhëzimi Administrativ** i mësipërm.
2. Siguron që studentët e testuar të deklarojnë qartë nëpërmjet aplikimit Online: <http://www.registration.sta-edu.com/>, të dhënat personale si *emër, mbiemër, numrin e kartës së identitetit, vendlindjen dhe vendbanimin, si dhe të dhëna të tjera që mund të kërkohen*.
3. Siguron testimin për studentët e UKZ-së dhe për të gjithë ata që aplikojnë, për të zhvilluar testimin në ambientet UKZ-së në Gjilan.
4. Paraqet të dokumentuar zyrtarisht rezultatin (pikët e testimit) të studentëve në Rektorat, nëpërmjet certifikimit edhe/ose score report dhe një Rosteri përkatës.
5. Merr përsipër korrigjimin, shpërndarjen dhe administrimin e testeve, duke ruajtur Standardin Ndërkombëtar, nëpërmjet një personeli terësisht amerikan.
6. Kujdeset për mirëmbajtjen e ambienteve të testimit të studentëve të vëna në dispozicion nga UKZ.
7. Dëmshpërblen UKZ-në në rastin kur ky i fundit konstaton se është cenuar baza materiale e tij gjatë zhvillimit të testimit.

8. Nuk cenon normalitetin e zhvillimit të procesit mësimor, duke i zhvilluar testet vetëm në datat e përcaktuara në kalendarin e zhvillimit të testeve dhe të miratuar nga UKZ: <https://sta-edu.com/exams-kosovo/>
9. S.T.A garanton që për çdo sesion testimi do ti ofrojë UKZ-së testim falas për një (1) personel nga UKZ dhe për një (1) student të shkëlqyer (ekselent).
10. S.T.A do të ofrojë të gjitha materialet përgaditore për studentët e UKZ-së FALAS.
11. Pas nënshkrimit të këtij Protokolli certifikon UKZ-në si *Authorized Test Center for ETS tests*.



Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e UKZ-së

1. Miraton kalendarin e zhvillimit të testeve.
2. Kërkon dëmshpërblim monetar në rastin kur konstaton se është cenuar baza materiale e Universitetit, sipas një proces verbal të mbajtur që dëshmon dëmin e shkaktuar.
3. Ofron ambientet e universitetit me qëllim garantimin e respektimit të standardeve dhe të cilësisë së testimit.
4. Merr përsipër ruajtjen e të dhënave personale dhe të rezultateve të testimit, të cilat vihen në dispozicion nga S.T.A në përputhje me konventat ndërkombëtare si dhe legjislacionit në fuqi.
5. Publikon ne web faqen e tij: <https://www.uni-gjilan.net/> dhe në ambientet e universitetit listën e testeve të ETS të njohura ndërkombëtarisht (**TOEFL ITP®**, **TOEIC®** L&R dhe **TFI™**) në zbatim të këtij Protokolli.
6. Cakton një koordinator të përhershëm për mbarevajtjen e këtij Protokolli, i cili do të jetë përgjegjës për shpërndarjen e rezultateve tek studentët dhe ruajtjen e të dhënave personale të tyre.

Neni 5

Procedura për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes palëve




Në rast se njëra nga palët, UKZ ose STA kërkon të zgjidhë këtë Protokoll Bashkëpunimi, atëherë ajo duhet të njoftojë palën tjetër me shkrim jo më pak se 30 ditë, përpara ndërprerjes së këtij Protokoll.

Neni 6

Respektimi i detyrimeve

Palët angazhohen se duhet të zbatojnë me përpikmëri nenet e këtij Protokoll.

Ky Protokoll përpilohet në 2 (dy) kopje, ku secila palë merr nga një (1) kopje.

Për UKZ:		Për S.T.A:	
Emri:	Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi	Emri:	Prof. Ass. Ines Dika
Pozitat:	Rektor, UKZ	Pozita:	Përfaqësuese e Përhershme
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data/ Vendi:	18 Mars 2019, Gjilan	Data/ Vendi:	18 Mars 2019, Gjilan
Vula:		Vula:	